

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Agjencia Qendrore e Prokurimit**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **201/26300-26-2068-1-1-1**

Sa i përket tenderit për **Furnizim me karburante**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj

N.T. „Fer-Petroll

NUI

810247967

Adresa

Terstenik-Gllgoc

Vendi

Gllgoc

Kodi postar

13000

Numri Telefonit

Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj

Mehdi Gjoka

Adresa elektronike

fer-petroll@hotmail.com

Data e parashtrimit të ankesës

05.06.2026

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

Emri i avokatit

Adresa e plotë

Numri i Telefonit

Numri i faks-it

Adresa elektronike

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës” “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit”, apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Ankesa i përket grupeve:

Lot 1 – Furnizim me karburante për nevojat e Policisë së Kosovës][**Lot 2 – Furnizim me karburante për vetura për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror**][**Lot 3 – Furnizim me karburante për nevojat e MM dhe FSK-së**][**Lot 4 – Furnizim me karburante për nxehmje gjenerator dhe rezerva për nevojat e institucioneve publike të Nivelit Qendror**][**Lot 5 – Furnizim me karburante për Rajonin e Prishtinës (Nivel Lokal)**][**Lot 6 – Furnizim me karburante për Rajonin e Prizrenit (Nivel Lokal)**][**Lot 7 – Furnizim me karburante për Rajonin e Pejës dhe Gjakovës (Nivel Lokal)**][**Lot 8 – Furnizim me karburante për Rajonin e Ferizajit dhe Gjiçanit (Nivel Lokal)**][**Lot 9 – Furnizim me karburante për Rajonin e Mitrovicës (Nivel Lokal)**

B05 Njoftim për Kontratë me dt 17.04.2026

B54 Formulari standard për korrigjimin e gabimeve në njoftimet e publikuara me 20.05.2026

Kerkesa për rishqyrtim 28.05.2026

Pergjigje në kerkese për rishqyrtim 29.05.2026

Hapja e ofertave është me dt 09.06.2026

Kriteret e Dhënies: Tenderi i përgjegjshëm me çmim me të lirë,

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontestit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A

te LPP-se.

Duke u bazuar në Njoftimi për kontratë dhe Dosjen e tenderit, mendojmë se AK-Komuna e Drenasit nuk ka rrespektuar, Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,

I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092LPP-së Paragrafi 1 i Neni 1, Paragrafi 1 i Neni 2, paragrafi 1 dhe 2 I Neni 6 dhe paragrafi 6 I Neni 7, si dhe RREGULLORE Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLI Paragrafi 4.3 Neni 4. Zyra e prokurimit, ka për obligim ti shfrytëzon te gjitha mundësit me qellim që mos të bënë shkelje te Ligji Nr. 04/L-042 PËR PROKURIMIN PUBLIK TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,

I ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092LPP-së

Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike”.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së /Qëllimi

Neni 2 i LPP-së /Fushëveprimi

Neni 6 i LPP-së /Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 i LPP-së/ Barazia ne trajnim /Jo –Diskriminim

Neni 59 i LPP-së Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

Neni 64 i LPP-së/ Dëshmitë e kërkesave

Neni 66 i LPP-së/ Përshtatshmëria Profesionale

RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E

RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Neni 26/ Grupi i Operatorëve Ekonomik

Neni 38/ Sqarimi i tenderëve

Neni 40/ Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve

*** Sipas Neni 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjorbë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë e rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Operatori Ekonomik N.T. "Fer Petrol", si palë me interes në aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizim me karburante", pas tërheqjes dhe analizimit të dokumentacionit të tenderit në platformën elektronike e-prokurimi, ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues ka vendosur kritere të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (në vijim: LPP), si dhe me dispozitat e Rregullores Nr. 001/2022 dhe Rregullores Nr. 002/2024 për Prokurimin Publik.

Konkretisht, kontestojmë kriterin si në vijim:

Kërkesa 4:

"Garancion apo autorizim apo konfirmim nga rafineria/prodhuesi."

Evidenca 4:

"Garancion apo autorizim apo konfirmim nga prodhuesi – rafineria, që garanton se do të furnizojë për kontratën/lotin e specifikuar në të cilin ofertoni – origjinal, i nënshkruar dhe i vulosur."

Kriteri i lartcekur është diskriminues, kufizues dhe jo proporcional me objektin e kontratës, pasi në praktikën tregtare furnizimi me derivate realizohet përmes distributorëve të autorizuar dhe jo domosdoshmërisht drejtpërdrejt nga rafineritë prodhuese.

Vendosja e kriterit që autorizimi të lëshohet vetëm nga rafineria/prodhuesi:

- kufizon konkurrencën e lirë;
- favorizon operatorë të caktuar ekonomikë;
- përjashton operatorët ekonomikë që furnizohen ligjërisht nga distributorë të autorizuar;
- cenon parimin e trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit.

Ky kriter nuk është në përputhje me nenin 7 të LPP-së, sipas të cilit autoriteti kontraktues është i obliguar të sigurojë trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë.

Gjithashtu, kriteri nuk është proporcional me objektin e kontratës, pasi cilësia, origjina dhe siguria e furnizimit mund të dëshmohen edhe përmes autorizimeve të lëshuara nga distributorët zyrtarë të rafinerive/prodhuesve.

Për këtë arsye, me datë 19.05.2026 kemi kërkuar sqarime shtesë nga Autoriteti Kontraktues, duke propozuar që të pranohet edhe autorizim apo konfirmim i lëshuar nga distributori zyrtar i rafinerisë/prodhuesit. Megjithatë, Autoriteti Kontraktues nuk e ka marrë parasysh kërkesën tonë dhe nuk ka bërë ndryshime në kriterin e kontestuar.

Si rezultat, duke konsideruar se na është mohuar e drejta për pjesëmarrje të barabartë në këtë aktivitet të prokurimit, jemi të obliguar të paraqesim këtë kërkesë për rishqyrtim, duke pretenduar se janë shkelur dispozitat si në vijim:

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi;
- Neni 2 i LPP-së – Fushëveprimi;
- Neni 6 i LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
- Neni 7 i LPP-së – Barazia në trajtim / Jo-diskriminimi;
- Neni 59 i LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Neni 60 i LPP-së – Kriteret për dhënien e kontratës;
- Neni 64 i LPP-së – Dëshmitë e kërkesave;
- Neni 66 i LPP-së – Përshtatshmëria profesionale;

Gjithashtu konsiderojmë se janë cenuar edhe dispozitat e:

RREGULLORES Nr. 002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E

RREGULLORES Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, përkatësisht:

- Neni 26 – Grupi i Operatorëve Ekonomik;
- Neni 38 – Sqarimi i tenderëve;
- Neni 40 – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve.

Autoriteti Kontraktues, gjatë hartimit të dokumentacionit të tenderit, duhet të vendosë kritere proporcionale, të arsyeshme dhe jo diskriminuese, të cilat nuk kufizojnë konkurrencën dhe nuk favorizojnë operatorë të caktuar ekonomikë.

Në rastin konkret, kërkesa për autorizim ekskluzivisht nga rafineria/prodhuesi nuk është kriter proporcional me objektin e kontratës, pasi cilësia dhe origjina e karburanteve mund të dëshmohet edhe përmes distributorëve të autorizuar, të cilët operojnë ligjërisht në treg. Po ashtu, Zyra e Prokurimit ka për obligim që, në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, të sigurojë:

1. Shfrytëzim efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike;
2. Trajtim të barabartë për të gjithë operatorët ekonomikë;
3. Konkurrencë të lirë dhe efektive;
4. Mosvendosje të kriterëve diskriminuese apo kufizuese.

I. KONKLUZION PËRFUNDIMTAR I ANKESËS PAS REFUZIMIT TE KERKESES PER RISHQYRTIM

Duke u bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura më lart, rezulton se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik, në veçanti parimet themelore të transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së ndershme.

Autoriteti Kontraktues nuk i ka trajtuar në mënyrë të arsyetuar pretendimet tona ankimore, ka tejkaluar objektin e shqyrtimit ankimor, Operatori Ekonomik N.T. “Fer Petrol” Sh.p.k. mbetet pranë të gjitha pretendimeve të paraqitura në kërkesën për rishqyrtim dhe konsideron se vendimi i Autoritetit Kontraktues për refuzimin e saj është i pabazuar në fakte dhe në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik.

Objekt i kontestimit mbetet kërkesa në Njoftimin për kontratë dhe Dosjes së Tenderit: “Garancion apo autorizim apo konfirmim nga rafineria/prodhuesi”, respektivisht kërkesa që ky dokument të lëshohet ekskluzivisht nga rafineria apo prodhuesi.

Autoriteti Kontraktues në përgjigjen e tij arsyeton se kjo kërkesë është vendosur për të garantuar furnizim të sigurt dhe të pandërprerë me karburante për institucionet publike. Mirëpo, AK nuk ka ofruar asnjë argument juridik, teknik apo profesional që dëshmon se i njëjti qëllim nuk mund të arrihet edhe përmes autorizimit, garancionit apo konfirmimit të lëshuar nga distributori zyrtar i rafinerisë/prodhuesit.

Thelbi i pretendimit tonë nuk ka qenë kundërshtimi i nevojës për të dëshmuar kapacitetin furnizues apo sigurinë e furnizimit, por kufizimi i panevojshëm i mënyrës së dëshmimit të këtij kapaciteti. Autoriteti Kontraktues nuk ka arsyetuar pse një dokument i lëshuar nga distributori zyrtar i rafinerisë nuk konsiderohet dëshmi e mjaftueshme për realizimin e kontratës.

Në tregun e derivateve të naftës furnizimi realizohet kryesisht përmes distributorëve të autorizuar, të cilët operojnë mbi bazën e marrëdhënieve kontraktuale me rafineritë dhe prodhuesit. Për pasojë, distributorët e autorizuar janë pjesë e zinxhirit zyrtar dhe ligjor të furnizimit dhe konfirmimi i tyre përfaqëson një garanci reale dhe të vlefshme për

sigurimin e produktit.

Për më tepër, vetë Autoriteti Kontraktues në përgjigjen e tij ka trajtuar piken ku “ shumica dërrmuese e operatorëve ekonomikë furnizohen nga i njëjti burim, respektivisht nga i njëjti grup rafinerish”. Ky konstatim e mbështet edhe më shumë pretendimin tonë, pasi dëshmon se origjina dhe cilësia e produktit nuk janë çështje kontestuese. Në këto rrethana, kriteri i kontestuar nuk shërben për verifikimin e burimit të furnizimit, por vetëm kufizon formën e dokumentit përmes të cilit dëshmohet ky furnizim.

Parimi i proporcionalitetit kërkon që kriteret e vendosura nga Autoriteti Kontraktues të jenë të nevojshme dhe të përshtatshme për arritjen e qëllimit të synuar dhe të mos kufizojnë konkurrencën më shumë sesa është e nevojshme. Në rastin konkret, AK mund të arrinte të njëjtin qëllim duke pranuar:

- autorizim nga distributori zyrtar;
- kontratë furnizimi;
- ose dokumente të tjera që dëshmojnë zinxhirin e furnizimit.

Përderisa ekzistojnë mënyra të tjera të vlefshme dhe më pak kufizuese për të dëshmuar sigurinë e furnizimit, kërkesa që dokumenti të lëshohet vetëm nga rafineria/prodhuesi përbën masë joproporcionale dhe kufizuese.

Në praktikë, efekti i këtij kriteri është përjashtimi i operatorëve ekonomikë që furnizohen në mënyrë të ligjshme përmes distributorëve të autorizuar, ndonëse ata kanë kapacitet të plotë teknik, profesional dhe financiar për realizimin e kontratës. Kjo sjell kufizim artificial të konkurrencës dhe zvogëlim të numrit të operatorëve ekonomikë që mund të marrin pjesë në procedurë.

Nëse një operator ekonomik posedon licencat e nevojshme, infrastrukturën e kërkuar, kontrata të rregullta furnizimi, kapacitet për furnizim dhe mund të sigurojë produkte me origjinë dhe cilësi të garantuar, nuk ekziston asnjë arsye objektive dhe proporcionale që ai të përjashtohet vetëm për shkak se dokumenti i furnizimit është lëshuar nga distributori zyrtar dhe jo drejtpërdrejt nga rafineria.

Për rrjedhojë, konsiderojmë se Autoriteti Kontraktues ka vendosur një kriter që kufizon konkurrencën pa ndonjë nevojë objektive, po ashtu ka pas raste vet AQP qe ne lidhje me ket kriter ka bër ndryshime ku ju është ofruar OE qe te kenë autorizim edhe nga distributore, per ndryshe nëse nuk e ben nje lëshim te till AK-AQP-ë është duke vepruar në kundërshtim me:

- Nenin 1 të LPP-së – Qëllimi;
- Nenin 6 të LPP-së – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti;
- Nenin 7 të LPP-së – Barazia në trajtim dhe Mosdiskriminimi;
- Nenin 59 të LPP-së – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve;
- Nenin 64 të LPP-së – Dëshmitë e kërkesave;
- Nenin 66 të LPP-së – Përshtatshmëria Profesionale;

si dhe me parimet themelore të konkurrencës efektive dhe proporcionalitetit të përcaktuara në legjislacionin e prokurimit publik.

Duke qenë se AK nuk ka arritur të dëshmojë pse vetëm autorizimi nga rafineria/prodhuesi është i pranueshëm, ndërsa autorizimi nga distributori zyrtar i së njëjtës rafineri nuk është i pranueshëm, konsiderojmë se vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pabazuar dhe duhet të anulohet.

Për këto arsye kërkojmë nga OSHP që:

1. Ta aprovojë ankesën si të bazuar;
2. Ta anulojë vendimin e Autoritetit Kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim;
3. Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që ta korrigjojë Dosjen e Tenderit duke lejuar që kërkesa të përmbushet edhe me autorizim, garancion apo konfirmim nga distributori zyrtar i rafinerisë/prodhuesit;
4. Ta obligojë Autoritetin Kontraktues që procedurën ta zhvillojë në përputhje me parimet e proporcionalitetit, konkurrencës së lirë, trajtimit të barabartë dhe mosdiskriminimit

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si OE na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, përgatitjen e kërkesës për Rishqyrtim, si dhe fitimi i pa realizuar lidhur me këtë kontratë në shumën 150,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*